

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË HAPJEN E EDICIONIT TË GJASHTË TË “DITËVE TË KUJTESËS”

19 shkurt 2021

Ju falënderoj për këtë mundësi të veçantë për të qenë pjesë e këtij diskutimi!

Me shumë kënaqësi dhe përkushtim të vërtetë ndaj përparimit të Shqipërisë, pranova të kontribuoj në ceremoninë e hapjes së edicionit të gjashtë të “Ditëve të Kujtesës”.

Shqipëria ka bërë një rrugëtim të gjatë që nga shembja e diktaturës. Shumë të rinj kanë dëgjuar për ato kohëra nga të tjerët, dhe shumë syresh nuk kanë përvojë personale të drejtpërdrejtë nga regjimi. Për brezat e ardhshëm, regjimi do të jetë një kapitull në librat e tyre të historisë.

E kaluara mund të kuptohet përmes një dialogu racional, të matur dhe të gjithëpranuar, përfshirë edhe përmes hulumtimeve të hollësishme rreth asaj kohe, në mënyrë që mësimet e nxjerra të integrohen në shoqërinë e tanishme, për të mos rënë në grackën e harrimit të së kaluarës.

Dialogu është fjala kyçe. Në fakt, muzetë nuk janë raste të mjaftueshëm për të folur për të kaluarën. Në muze, shohim një jetë të balsamosur. Ata shuajmë kureshtjen dhe plotësojmë njohuritë tona, por rrallë na frymëzojnë për të krijuar një kryevepër dhe për të projektuar të ardhmen tonë. Ata nuk na japin guximin e nevojshëm në sjelljen tonë të përditshme. Mbajtja gjallë e kujtesës do të thotë të shpëtosh jetët nga rrjedha e pamëshirshme e kohës dhe nga dhuna njerëzore. Në kujtesë futet një ngjarje që ndihmon jetën.

Objektivi ynë për të mbajtur gjallë dhe nderuar kujtesën është, në të vërtetë, shumë më i madh dhe i rëndësishëm sesa thjesht shpluhurosja e së kaluarës së afërt të Shqipërisë. Ideja themelore është më së paku e trefishtë: të respektojmë viktimat; të mos lejojmë që përmbajtja e asaj tragjedie të përsëritet, sikurse ka thënë Hannah Arendt; dhe të mbështetim përpjekjet e Shqipërisë për të ndërtuar një shoqëri gjithnjë e më të fortë dhe të sigurt.

“Ditët e Kujtesës” i shërbejnë këtij misioni, dhe mundësohen nga Instituti Shqiptar për Demokraci, Media dhe Kulturë dhe Fondacioni “Konrad Adenauer”, si dhe të gjithë partnerët e tjerë, përfshirë edhe Prezencën e OSBE-së.

Ato u krijojnë hapësirë studiuesve për t’u mbledhur dhe për të diskutuar për gjetjet e tyre, u japin historianëve arsyet për të rishikuar të kaluarën, si dhe japin ndihmesën e tyre në edukimin e brezit të ri.

Unë jam, gjithashtu, shumë i kënaqur kur shoh se shumë institucione dhe partnerë, si dhe shumë organizata të shoqërisë civile, punojnë intensivisht për të trajtuar çështjen e trashëgimisë sociale dhe politike të regjimit komunist të Shqipërisë.

Unë përgëzoj punën e Autoritetit për Dosjet e Sigurimit. Ky është një institucion kyç në procesin e trajtimit të së kaluarës.

E kam takuar znj. Gentiana Sula, Kryetaren e Autoritetit, dhe kemi pasur një diskutim të hapur për atë që duhet bërë.

Kjo është një përpjekje kolektive për të mirën e të gjithë shoqërisë. Secili mund të luajë rolin e tij: Instituti i Studimeve për Krimet e Komunizmit, Instituti Shqiptar për Demokraci, Media dhe Kulturë, por nevojitet edhe puna e shumë të tjerëve, para së gjithash e shoqërisë civile.

Mund t'ju siguroj se Prezenca e OSBE-së në Shqipëri do të vazhdojë angazhimin e saj duke i ofruar publikut, në përgjithësi, dhe studentëve, në veçanti, një mundësi për të mësuar se si shoqëritë trajtojnë të kaluarën diktatoriale që i ka traumatizuar.

Me kënaqësi ju bëj me dije që Prezenca po mbështet zhvillimin e një programi akademik të nivelit master për Drejtësinë Transitore në Universitetin e Tiranës. Ky program është pjesë e përpjekjeve për trajtimin e të këqijave të së kaluarës.

Ne presim me padurim që ky program të miratohet përfundimisht nga Ministria e Arsimit, pasi ka nevojë për këtë mbështetje institucionale. Nuk mund ta shpreh me fjalë se sa e rëndësishme është kjo sferë e punës për shoqërinë dhe për funksionimin e përgjithshëm të demokracisë shqiptare.

Me mbështetjen e Prezencës është ngritur së fundmi, në Universitetin e Tiranës, edhe Qendra për Drejtësi dhe Transformim, e cila synon të shërbejë si një qendër për dialogun mbi drejtësinë transitore, në fusha të tilla si të drejtat e njeriut, demokratizimi dhe shteti ligjor.

Jam i lumtur t'ju njoftoj se Prezenca ka akorduar fonde nga buxheti i vitit 2021 për projekte që përqendrohen në çështjet që kanë të bëjnë me identifikimin dhe gjetjen e trupave të personave të zhdukur, të ekzekutuar pa gjyq nga regjimi komunist.

Për këtë qëllim, së bashku me Qendrën për Drejtësi dhe Transformim, të krijuar nga Prezenca në vitin 2020, Zyra e saj në Shqipëri do të mbështesë zhvillimin e një numri punimesh kërkimore në fushat e ligjit, shkencave shoqërore dhe historisë.

Siç jam informuar nga kolegët e mi, Prezenca, gjithashtu, do të kontribuojë përmes organizimit të tryezave të rrumbullakëta që do të shërbejnë si platforma diskutimi lidhur me sfidat me të cilat përballen institucionet në ecjen e tyre përpara, veçanërisht sa u takon procedurave hetimore për rastet e personave të zhdukur.

Në fund, përfitoj nga rasti t'ju siguroj se, si Prezencë e OSBE-së, ne do të vazhdojmë të mbështesim punën dhe përpjekjet e të gjitha institucioneve përkatëse shqiptare të përfshira në fushën e drejtësisë transitore dhe trajtimit të së kaluarës. Kjo është një punë që bëhet bashkërisht dhe, për këtë arsye, na duhet besimi dhe mbështetja juaj.

Ju falënderoj që më ftuat të marr pjesë në “Ditët e Kujtesës” dhe pres me kënaqësi vijimin e bashkëpunimit mes organizatave tona.

Fund